



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Nr. 4957 / 6 Prot.

Tiranë, më 15.01.2018



MIRATOHET

MINISTRI

LËNDITA NIKOLLA

PROGRAM ORIENTUES PËR MATUREN SHTETËRORE

LËNDA: GJUHË ANGLEZE  
Provim me zgjedhje (Niveli B2)

Viti shkollor 2017 - 2018

Tiranë, janar 2018



---

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË

**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

---

**PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE**

**LËNDA:**  
**GJUHË ANGLEZE**  
**PROVIM ME ZGJEDHJE (Niveli B2)**

**Viti shkollor 2017 – 2018**

## 1. SYNIMET E PROGRAMIT

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si lëndë me zgjedhje, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Niveli i njohurive i përket nivelit **B2** sipas dokumentit evropian “Kuatridi i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët.

Ky program duhet të nxisë inspirim dhe sfidë për të gjithë nxënësit dhe t’i përgatisë ata për të ardhmen. Programi Orientues është ndërtuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve si dhe zhvillimet e tyre personale.

Ky program synon:

- të ndihmojë nxënësin maturant në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës angleze si provim me zgjedhje në nivelin gjuhësor B2, bazuar në nivelet gjuhësore të përcaktuara në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Gjuhëve;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t’u dhënë orientimet e duhura nxënësve për mënyrën se si të mbështeten në këtë program dhe çfarë duhet të dinë ata për të realizuar me sukses këtë provim përmbyllës të dijeve të tyre në këtë lëndë;
- orientimin e vlerësimit që do të përfshijë 2 aftësi kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj ‘të lexuarit dhe të kuptuarit’ dhe ‘të shprehurit me shkrim’.) si dhe konceptet gjuhësore, gramatikore dhe funksionale të domosdoshëm për nivelin B2;
- të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën angleze si provim me zgjedhje.

## 2. UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballlet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

*Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (Sports and Entertainments, Travel Time, Environmental Issues, Modern Living, Education, etc.)*

*Përsa i përket përdorimit të gjuhës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që ata kanë trajtuar gjatë viteve të shkollës së mesme. (passive voice, conditionals, reported speech, verb tenses, adverbs and adjectives comparisons, prepositions, connectors; vocabulary related to entertainments, hobbies, food, celebrations, holiday destinations, types of travel, weather conditions, environmental issues, science, technology, fashion, etc) duke dalë nga konteksti i mësimëve ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë gap-fill, sentence transformation, matching, etj.*

*Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto nocione gjuhësore:*

- *Expressing interests*
- *Giving personal information*
- *Recommending places*
- *Making suggestions (proposals, comments)*
- *Suggesting and reaching a decision*
- *Expressing similarities and differences*
- *Likes and dislikes*
- *Inviting*
- *Asking and answering personal questions*
- *Complaining and apologizing*

*Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme të të shkruarit si:*

- *email to a friend about a travel experience.*
- *a short review of a film, story, book, etc.*
- *Letters or emails of recommendation*
- *Narrative or descriptive letters or emails*
- *Describing of a movie, concert, festival*
- *A summary of a text, story, etc.*
- *Descriptive and argumentative essay*

### **3. AFTËSITË DHE NJOHJET QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME ZGJEDHJE NË GJUHËN ANGLEZE NË NIVELIN B2**

Nxënësi që do t'i ushtrohet provimit të maturës me zgjedhje, në gjuhën angleze duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohuritë** e tij për çka ka marrë dhe përfituar nga të nxënët në këtë lëndë gjatë viteve të shkollës së mesme. Përshkrimin e kompetencave dhe njohurive po i paraqesim në gjuhën angleze pasi nxënësi është njohur me to në Portofolin Evropian të gjuhëve ku jepet përshkrimi për çdo nivel gjuhësor.

#### ***Reading and Comprehension***

Students at level B2 should understand articles and reports concerned with contemporary problems in which the writers adopt particular stances or viewpoints. They can understand contemporary literary prose and can adapt style and speed of reading to different texts and purposes, using appropriate reference-sources selectively.

- *Students should read correspondence relating to their fields of interest and easily understand the essential meaning.*
- *They should understand specialized articles outside their field, provided that they can use a dictionary to confirm terminology.*
- *They should read many kinds of texts quite easily at different speeds and in different ways according to their purpose in reading and the type of text.*
- *They should quickly identify the content and relevance of news items, articles and reports on a wide range of professional topics, deciding whether closer study is worthwhile.*
- *They should understand articles and reports concerned with contemporary problems in which the writers adopt particular stances or viewpoints.*

### **Writing:**

Students at level B2 should be able to write clear, detailed text on a wide range of subjects related to their interests.

- *They should write an essay or report, passing on information or giving reasons in support of or against a particular point of view.*
- *They should write letters highlighting the personal significance of events and experiences.*
- *They should synthesize information and arguments from a number of sources.*
- *They should construct a chain of reasoned argument and can speculate about causes, consequences and hypothetical situations.*

### **Use of English**

#### **Functions/ notions**

- *Describing experiences*
- *Describing feelings and emotions*
- *Describing hopes and plans*
- *Giving precise information*
- *Expressing abstract ideas*
- *Expressing certainty, probability, doubt*
- *Generalizing and qualifying*
- *Synthesizing, evaluating, glossing information*
- *Speculating*
- *Expressing opinions*
- *Expressing agreement/ disagreement*
- *Expressing reaction, e.g. indifference*
- *Critiquing and reviewing*
- *Developing an argument in academic discourse style*

#### **Verb forms**

- *Simple past (narrative)*
- *Past continuous (narrative)*
- *Used to (narrative)*
- *Would expressing habit in the past*
- *Past perfect*

- *Past perfect continuous*
- *Future time (will & going to)*
- *Future continuous (Prediction)*
- *Future perfect*
- *Future perfect continuous*
- *Present Perfect*
- *Present perfect continuous*
- *Mixed conditionals*
- *Wish*
- *Extended phrasal verbs*
- *All passive forms*
- *Reported speech (range of tenses)*
- *Relative clauses*
- *Modals of Deduction and Speculation*
- *Modals: can't have, needn't have*
- *Articles*
- *With abstract nouns*
- *Adjectives and adverbs*
- *Attitudinal adverbs*
- *Collocation of intensifiers*

#### **4. STRUKTURA E PROVIMIT TË MATURËS SHITETËRORE ME ZGJEDHJE, GJUHA ANGLEZE ME DETYRIM NË NIVELIN B2**

Testi i gjuhës angleze me zgjedhje në nivelin gjuhësor B2 do të jetë i ndarë në 3 seksione ku testohen:

- *Të kuptuarit e një pjesë letrare ose jo letrare*
- *Përdorimi i gjuhës që përfshin aspektet më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore trajtuar në vitet e shkollës së mesme*
- *Të shkruarit*

	<b>Seksioni 1</b>	<b>Seksioni 2</b>	<b>Seksioni 3</b>
--	-------------------	-------------------	-------------------

<b>Pesha që zë çdo seksion në test</b>	<b>Leximi dhe të Kuptuarit</b>	<b>Përdorimi i Gjuhës</b>	<b>Të Shkruarit</b>
<b>Në %</b>	<b>40%</b>	<b>40%</b>	<b>20%</b>

**5. OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT TË NDARA DHE DETAJUARA SAKTËSISHT SIPAS TRE NIVELEVE PËR GJUHËN ANGLEZE SI PROVIM ME ZGJEDHJE NË NIVELIN B2**

**a) Për të lexuarit dhe të kuptuarit (B2)**

<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi kupton tekste letrare dhe jo letrare mbi tema të caktuara por të njohura nga fusha të ndryshme të jetës por shkruar jo me gjuhë akademike.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi kupton tekste ku trajtohen tema të aktualitetit dhe kryesisht tema që u interesojnë botës së tyre.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi merr dhe përzgjedh Brenda një teksti informacionin e duhur.</li> <li>- Vlerëson nxënësit për të kuptuarit global të tekstit.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi di të plotësojë pyetje leksikore rreth tekstit, ose di të gjejë fjalët referuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të lexojë dhe kuptojë artikuj, raporte mbi çështje bashkëkohore ku autorët shprehin qëndrimet e tyre.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi në këto tekste të lartpërmendura di të shprehë opinionin e tij mbi të dhe të mbaj qëndrim në lidhje me tema të caktuara.</li> <li>- Vlerëson reflektimin mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrjen e informacionit të duhur prej tij.</li> <li>- Vlerëson paraqitjen e elementëve provues që mbështesin idenë e dhënë nga vetë nxënësi.</li> <li>- Vlerëson thellimin në kuptimin e një fraze dhe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi arrin në formimin i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrjen e moralit të pjesës.</li> <li>- Vlerëson zhvillimin e aftësisë krijuese dhe interpretuese dhe paraqitjen e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.</li> <li>- Vlerëson kuptimin e thelluar, gjetja e të pashprehurës ose idesë që nënkuptohet, qëndrimin e autorit duke bërë analiza dhe arsyetime për përfundimin e tij.</li> <li>- Vlerëson mbajtjen e një qëndrimi personal ndaj një teme të dhënë në tekst, argumentimin e dhënë për</li> </ul>



në të.	gjetjen e sinonimit të saj.	qëndrimin që nxënësi ka ndaj një çështje të caktuar.
--------	-----------------------------	--

**b) Për përdorimin e gjuhës (Gramatika dhe leksiku) (B2)**

<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi ka një kontroll të mirë gramatikor; nëse di të përdorë në kërkesa të ndryshme njohuritë gramatikore bazë të marra gjatë viteve të shkollës së mesme si: kohët e foljeve, fjalitë e nënrenditura dhe llojet e tyre, përemrat lidhorë, ndajfoljet dhe shkallët e tyre, përemrat e pacaktuar, lidhëzat, etj.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të bëjë përzgjedhjen e fjalës së duhur brenda një grupi fjalësh me kutim të ngjashëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të përdor saktë aspekte gramatikore si: parafjalët dhe shprehjet me parafjalë, format pësore të fjalive, ligjëratën e zhdrejtë, foljet modale, kushtoret 1, 2, etj.</li> <li>- Vlerëson nxënësin nëse mund të gjejë shprehjen e duhur leksikore në një transformim fjalish.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi ka stabilizuar fjalorin e tij për të shprehur një këshillë, sugjerim, dëshirë etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të përdor saktë aspekte gramatikore si: kombinimi i kohëve të foljeve në fjalitë komplekse, transformimi i fjalive jot ë thjeshta duke ruajtur kuptimin e tyre fillestar, format foljore të pazgjedhuara dhe përdorimi i saktë i tyre, foljet frazale, kushtorja 3, etj.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi ka të qartë dhe di të përdorë saktë fjalë dhe shprehje lidhur me funksione të ndryshme gjuhësore si: shprehje e besimit, mosbindjes, kundërshtimit, pranimit, dyshimit, kushtëzimit të një çështjeje, etj.</li> </ul>

**c) Të shkruarit (B2)**

<b>Niveli 1</b>	<b>Niveli 2</b>	<b>Niveli 3</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të shkruajë mbi një gamë të gjerë temash që lidhen me interesat e tij.</li> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të shkruajë letra personale dhe jo personale ku të bëj vlerësime rreth situatave të ndryshme duke shprehur qëndrimin e tij personal në to.</li> <li>- Mund të shkruajë letra personale ose përshkrime të përvojave dhe përshtypjeve personale mbi çështje të interesit të tij.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të shkruajë një raport ose artikull rreth një teme të caktuar duke shprehur argument dhe arsye për qëndrimin e tij pro, ose kundër çështjes që trajtohet në temën me shkrim.</li> <li>- Vlerësohet nëse di të shkruajë saktë një kërkesë formale zyrtare për punë, apo diçka tjetër me fjalor të përshtatshëm për këtë lloj shkrimi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerëson nëse nxënësi mund të shkruajë një ese duke transmetuar një informacion ose duke paraqitur arsyet pro dhe kundër një opinion të dhënë.</li> <li>- Vlerëson aftësinë e nxënësve për të shkruar një histori rreth një teme të caktuar; përdorimi i imagjinatës dhe koherenca e ngjarjeve trajtuar në këtë histori dhe fjalori i zgjedhur për të shprehur botën e tij në këtë krijim.</li> <li>- Nxënësi vlerësohet nëse mund të shkruaj një kritikë mbi një film, roman, artikull, etj.</li> </ul>

## **6. TIPE USHTRIMESH QË NXËNËSI DUHET TË PUNOJË PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN E MATURËS ME ZGJEDHJE NË GJUHËN ANGLEZE**

### **a) Tipet e ushtrimeve që mund të jepen në Reading Comprehension:**

- *True or False*
- *Multiple Choice* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna)
- *Arrangements of paragraphs* (vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve)

- *Sentence or phrase completion* (plotësimi i kuptimit të një fjalie ose fraze në një tekst të caktuar mbi një temë të caktuar)
- *Open answers* (përgjigje të hapura ku nxënësi shpreh mendimin dhe vlerësimin e tij rreth një çështjeje ose pyetjeje të caktuar rreth tekstit)
- *Short answers* (përgjigje të shkurtra, të dhëna me fraza ose fjali të shkurtra)
- *Matching* (Bashkimi i një pjese teksti me një pjesë tjetër që mungon dhe e plotëson kuptimin e tij në tërësi)

### **b) Në përdorimin e gjuhës:**

Tipat e ushtrimeve që do të përdoren në provimin me detyrim në gjuhën angleze mund të jenë të tipeve si më poshtë:

- *Multiple Choice* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna);

*An example:*

She hates -----.

- A) washing up
- B) To wash up
- C) Wash up
- D) To washing up

- *Gap-fill* (plotësimi i fjalisë me gjetjen e një fjalie ose fraze të duhur me të cilën ka kuptim fjalia ose fraza);

*Examples:*

#### **Complete the sentences with a suitable word.**

- a) Jane doesn't enjoy her job anymore. She is \_\_\_\_\_ because every day she does exactly the same thing.
- b) The more electricity you use, the \_\_\_\_\_ your bill will be.

- *Sentence Transformation* (shndërrim fjalish duke e strukturuar ndyshe, por duke i ruajtur kuptimin fillestar);

*An example:*

Despite knowing the area, I got lost.

## Although

I got lost \_\_\_\_\_ the area well.

- *Word Formation* exercises (ushtrime mbi mënyrat e fjalëformimit)

*An example:*

### Write the correct word in the gap using the word given in capitals.

Having friends is extremely important, and most people spend a lot of time with them.

But is there another important type of (a) FRIEND \_\_\_\_\_ that they may be missing out on? Would having a pet be just as good? There is some (b) EVIDENT \_\_\_\_\_ to support this interesting (c) SUGGEST \_\_\_\_\_. It is well-known that dogs can form strong bonds with \_\_\_\_\_ people, and can show signs of (d) HAPPY \_\_\_\_\_ if their owner suddenly leaves unexpectedly. In the same way, some people feel as close to their pets as to their human friends, gaining (e) STRONG \_\_\_\_\_ and comfort from their animals. It seems that the (f) CONNECT \_\_\_\_\_ between animals and people goes deeper than might be expected. Studies into the (g) BEHAVE \_\_\_\_\_ of the gorillas show that these creatures have (h) EMOTION \_\_\_\_\_ relationships that are not so different from your own.

c) **Në temën me shkrim**, nxëmësi duhet të jetë i aftë të prezantohet me punë të tilla si:

- Argumentative essay (pros and cons on a certain topic)
- Book, film, article Reviews (giving personal opinion and making a critical review)
- Composition on a certain topic (fiction or non-fiction)
- Formal requests letters, emails (job requests, hotel reservations, etc)
- Letters of complaints, etc.